



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



04/ 4057 2026

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORTI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE PËR MUAJIN PRILL 2026

Hani i Elezit, 2026

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për muajin Prill 2026, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësiive ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësiive, ka funksionuar kryesisht në katër (4) sektorë:

1. Sektori për buxhet
2. Sektori për financa,
3. Sektori për të hyra dhe
4. Sektori i tatimit në pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtoresha e drejtorisë dhe me një staf prej (7) zyrtarëve, gjatë muajit Prill 2026 kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtëm të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara në planin e punës së drejtorisë. Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Punët dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë këtij muaji, mund t'i veçojmë këto:

SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

- Deklarimi në Thesar obligimet e pa paguara dhe ato kontraktuale për muajin Mars 2026,
- Barazimi me Thesar periudha Janar-Mars 2026,
- Është dërguar për publikim borxhi publik i muajit Mars 2026 në ueb faqen komunale,
- Përgatitja dhe publikimi i raportit të punëve dhe aktiviteteve të muajit Mars 2026, në dy formate: Word dhe PDF,
- Hartimi i raportit mujor të të hyrave dhe shpenzimeve të muajit Mars 2026,
- Përgatitja dhe dorëzimi i lëndëve të kërkuara nga DAB-MFPT dhe ZKA,
- Plotësimi i një pyetësoi nga Divizioni i Auditimit të Brendshëm – MFPT,
- Hartimi i Raportit Financiar për periudhën Janar-Mars 2026 dhe dorëzimi i Raportit për diskutim në KPF dhe Kuvend Komunal,
- Përgatitja e kërkesës për bartjen e bilancit të pashpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026 dhe dorëzimi për miratim në KPF dhe Kuvend Komunal,
- Përgatitja e një kërkesë për miratim nga KPF dhe Kuvendi Komunal lidhur me futjen e një projekti të ri kapital në kuadër të Buxhetit të vitit fiskal 2026,
- Është përgatitur një përgjigje me shkrim për një informacion të kërkuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa,
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuar për pagesën e pagave dhe shtesave të Administratës Komunale, të këshilltarëve Komunal, komiteteve të ndryshme të Kuvendit, të Sektorit të Arsimit dhe Sektorit të Kujdesit Primar Shëndetësor.

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR MUAJIN PRILL 2026

Kategoritë ekonomike të shpenzimeve	Realizimi Prill 2026
Paga dhe shtesa	210,717.67
Mallra dhe shërbime	41,312.67
Shpenzime komunale	13,140.89
Subvencione dhe trans.	-
Shpenzime kapitale	98,881.80
TOTAL	364,053.03

SEKTORI PËR TË HYRAT

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2026 është në shumë prej 356,720.00 €. Inkasimi i të hyrave për muajin Prill është në shumë prej 75,578.03 € apo 21% nga projeksioni i THV.

Ndërsa inkasimi i të hyrave direkte dhe indirekte nga Janari deri në Prill është në shumë prej 126,988.10 € apo 35.5 % prej projeksionit të THV.

- Regjistrimi, harmonizimi i të hyrave ditore në SIMFK.

SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë këtij muaji, ky sektor ka kryer shërbime të rregullta ndaj qytetarëve, siç janë:

- Lëshimin e faturave të tatimit në pronë,
- Lëshimin e vërtetimeve për qëllime të ndryshme,
- Përgatitja e një Njoftimi për afatin e pagesesës së kështit të parë të faturave të tatimit në pronë si dhe masat aplikuese në rast të mos pagesës,
- Publikimi i njoftimit në web faqen komunale dhe në faqen zyrtare në Facebook,
- Vizitë zyrtare e Inspektorave të Departamentit të Tatimit në Pronë.

Drejtores për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi

